

Në bazë të nenit 18, paragrafi (1), nënparagrafi 20 dhe neni 23, paragrafi (1), nënparagrafi 1 të Ligjit të Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr.42/20, 77/21, 154/23, 55/24, 193/24 dhe 247/25), dhe në lidhje me nenin 14 dhe nenin 29, paragrafi (2) të Ligjit për Mediume ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.184/13, 13/14 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr.63/24, 74/24, 218/24 dhe 87/25), Udhëzimin për përmbushjen e detyrimeve për impresium dhe informacionin e disponueshëm për përdoruesit, nr.ark.01-4443/1 të datës 09.10.2018, pika 7 dhe 14 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrjen e masës (Tekst i pastruar) nr.ark.01-4241/1 të datës 01.10.2025, Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer administrative nr.ark.10-2610/1 të datës 29.06.2026 dhe Konkluzionin nr.ark.02-2771/5 të datës 16.07.2026, Këshilli i Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele, në seancën e 26-të të mbajtur më 16.07.2026, miratoi:

### **Aktvendim për ndërmarrjen e masës – paralajmërim publik**

1. PUBLIKISHT PARALAJMËROHET Ndërmarrja publike radiodifuzive RADIOTELEVISIONI I MAQEDONISË Shkup – Televizioni i Maqedonisë – Shërbimi i tretë programor – Kanali 3 (RTM3), për shkeljen e kryer të nenit 14 nga Ligji për Mediume, të mënyrës që transmetuesi në kuadër të shërbimit programor televiziv (RTM3) transmetuar më 3 qershor 2026, në pjesë të programit të transmetuar, nuk ka publikuar të dhënat që është i detyruar t'i transmeton në vendin përkatës për çdo përmbajtje të shërbimit programor.

Shkelja e paragrafit 1 të kësaj pike është specifikuar në Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer administrative nr.ark.10-2610/1 të datës 29.06.2026, i cili është pjesë përbërëse e këtij aktvendimi si Shtojcë nr.1.

2. URDHËROHET që NPR RADIOTELEVISIONI I MAQEDONISË Shkup – Televizioni i Maqedonisë – Shërbimi i tretë programor – Kanal 3 (RTM3), në afat prej 20 (njëzet) ditësh nga dita e pranimit të Aktvendimit, të harmonizojë punën e sa me dispozitat e Ligjit për Mediume.

3. Pas skadimit të afatit të përcaktuar në pikën 2 të këtij Aktvendimi, të kryhet mbikëqyrje kontrolli për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrjes, i cekur në pikën 1 të këtij Aktvendimi, ka vepruar sipas aktvendimit.

4. Ky Aktvendim është përfundimtar dhe dita e miratimit llogaritet dita e çertifikimit në Arkivin e Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele (Agjencia).

### **A r s y e t i m**

Agjencia në bazë të nenit 29 të Ligjit të Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele (LSHMAAV) dhe nenit 29 të Ligjit për Mediume (LM), është kompetente të kryejë mbikëqyrje administrative të punës së botuesve të medias nga aspekti i harmonizimit të punës së tyre me detyrimet e përcaktuara në nenet 6, 8, 14 dhe 15 të LM-së.

Në pajtim me nenin 23, paragrafi (1), nënparagrafi 1 nga LSHMAAV, Këshilli i Agjencisë kundër botuesi të medias (transmetuesi) ndërmerr masë – paralajmërim publik në rastet kur është kryer cënim ose shkelje e dispozitave të LSHMAAV dhe akteve nënligjore të miratuara në bazë të

Ligjit të njëjtë, si dhe të kushteve dhe detyrimeve të përcaktuara në lejen dhe akte të tjera të Agjencisë.

Në pajtim me nenin 29, paragrafi (2) të LM-së, masat që Agjencia si organ rregullator kompetent mund t'i ndërmarrë dhe që janë të përcaktuara në LShMAAV-së, zbatohen përkatësisht dhe në rastet e shkeljes së dispozitave të LM-së.

Sipas nenit 14 të LM-së, botuesi i medias është i detyruar në vend të dukshëm për çdo bartës në veçanti të përmbajtjes (për shembull, kopje të medias së shtypit, emisioni televiziv dhe në pjesën për impresium të medias online – internet portalit) të sigurojë publikimin e të dhënave në vijim: emri dhe adresa e selisë dhe redaksisë së botuesit të medias, emri i personit përgjegjës të medias së shtypit, emri dhe mbiemri i redaktorit përgjegjës përkatësisht kryeredaktorëve në pajtim me organizimin e brendshëm të redaksisë dhe emri dhe adresa e shtypshkronjës dhe datën e botimit ose ribotimit si dhe numrin e kopjeve të shtypura, nëse kemi të bëjmë me medium të shtypit. Për transmetuesit detyrimi i lartpërmendur zbatohet në atë mënyrë që të dhënat publikohen në fillim dhe në fund të programve audio/audiovizuele. Botuesi i medias është i detyruar në vendin përkatës për çdo përmbajtje të publikojë të dhënat në vijim: emri dhe mbiemri i autorit të shtojcës së publikuar, emri dhe mbiemri i personit përkatësisht firmës bartëse të së drejtës autoriale për përmbajtjet e publikuara, vetëm në median e shtypit dhe programet në radio, datën e produksionit (muaji dhe viti) kur bëhet fjalë për veprë audio/audiovizuele, origjina e veprës audio/audiovizuele dhe nëse vepra është prodhuar nga produksion i pavarur dhe informacionin për të, emrin e personit juridik përkatësisht emri dhe mbiemri i personit që ruan trashëgimin kulturore të përdorur ose veprën arkivore, përkatësisht reproduksionin përkatës dhe emrin e botuesit të medias nga i cili është marrë shtojca programore ose pjesë e shtojcës programore, vetëm nëse me marrëveshje të përbashkët nuk është rregulluar ndryshe.

Në pajtim me pikën 6 të Udhëzimit për përmbushjen e detyrimeve për impresium dhe informacione të disponueshme për përdoruesit, nr.ark.01-4443/1 të datës 09.10.2018, në programet e tjera të prodhimit vendor, impresium publikohet në mënyrë që: në shpicën hyrëse dhe dalëse publikohen të dhënat në vijim: emri dhe mbiemri i redaktorit përgjegjës (kryeredaktorit) të shërbimit programor; emri dhe mbiemri i kryeredaktorit të redaksisë nga i cili buron programi (nëse ekziston); emri dhe mbiemri i redaktorit/autorit/moderatorit të emisionit; emri dhe mbiemri i kan-autorëve, përkatësisht të ekipit televiziv në përgjithësi me pjesëmarrje të plotë në veprën audiovizuele; emri i subjektit që ka prodhuar programin (të vetë transmetuesit, koproducentëve, producentit të pa varur të cilit i është porositur programi) dhe data e produksionit (viti dhe muaji). Nëse është e nevojshme, duhet të publikohen dhe të dhëna për: emri i personit juridik përkatësisht emri dhe mbiemri i personit që e ruan trashëgiminë kulturore ose veprën arkivore përkatësisht reproduksionin e veprës dhe emri i subjekti tjetër nga i cili është marrë shtojcë e caktuar ose pjesë e shtojcës vetëm nëse me marrëveshje të përbashkët nuk është rregulluar ndryshe.

Në kuadër të kompetencave ligjore, Agjencia përmes Sektorit për çështje programore më 29 qershor 2026, ka kryer mbikëqyrje të rregullt administrative (monitorim) të shërbimit programor televiziv të NPR RADIOTELEVISIONI I MAQEDONISË Shkup – Televizioni i Maqedonisë – Shërbimi i tretë programor – Kanal 3 (RTM3), transmetuar më 3 qershor 2026, në nivel shtetëror, ku është konstatuar shkelje e nenit 14 të LM-së, në mënyrë që në pjesën e programit të transmetuar më 3 qershor 2026, nuk u publikun të dhëna me të cilat: identifikohen autorët pjesëmarrës në përgatitjen e përmbajtjes audiovizuele, për bartësit e të drejtave autoriale, për redaktorin përgjegjës/redaktorët e programeve, për origjinën dhe datën e produksionit të veprave audiovizuele, emrin dhe datën nga ku është marrë përmbajtja, që transmetuesi është i detyruar t'i transmetojë në vendin përkatës për çdo përmbajtje të shërbimit programor. Gjithashtu, nga mbikëqyrja u konstatua se transmetuesi në kundërshtim me pikën 6 (impresium për programe të prodhimit vendas) nga Udhëzimi për përmbushjen e detyrimeve për impresium dhe informacione në dispozicion të përdoruesve gjatë transmetimit të reprizave të ndeshjeve sportive dhe transmetimit të ndeshjeve kombëtare, europiane ose ndërkombëtare, nuk janë publikuar të dhënat për impresium – autoriale, të ekipit realizues, kometatorëve, asistimit teknik, të dhënat për redaksinë dhe për (datën e) produksionit.

Shkelja nga pika 1 e këtij Aktvendimi është specifikuar në Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer administrative nr.ark.10-2610/1 të datës 29.06.2026, si pjesë përbërëse e këtij Aktvendimi si Shtojcë nr.1.

Në pajtim me nenin 23, paragrafi (3) të LShMAAV-së, Këshilli i Agjencisë drejtuar NPR RADIOTELEVISIONI I MAQEDONISË Shkup – Televizioni i Maqedonisë – Shërbimi i tretë programor – Kanal 3 (RTM3), me datë 02.07.2026, dërgoi Shkresë nr.ark.10-2610/2 datë

02.07.2026, me të cilën i dërgoi Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer administrative, nr.ark.10-2610/1 të datës 29.06.2026, me qëllim që në afat prej 7 (shtatë) ditë pune nga dita e pranimi të shkresës, drejtuar Këshillit të Agjencisë të paraqesë deklaram me shkrim për shkeljen e kryer të dispozitave të LM-së. Shkresa u pranua në mënyrë të rregullt nga transmetuesi më 02.07.2026 (nr.ark.03-3835/1 datë 02.07.2026). Me datë 14.07.2026, NPR RADIOTELEVIZIONI I MAQEDONISË Shkup – Televizioni i Maqedonisë – Shërbimi i tretë programor – Kanal 3 (RTM3), drejtua Agjencisë i dorëzoi Deklaratë me shkrim nr ynë.ark.10-2610/3 datë 14.07.2026. Këshilli i Agjencisë në seancën e mbajtur më 16.07.2026, pasi shqyrtoi lëndën Raport me shkrim dhe deklaramin me shkrim të dorëzuar nga transmetuesi, konkludoi që ndaj NPR RADIOTELEVIZIONI I MAQEDONISË Shkup –Televizioni i Maqedonisë – Shërbimi i tretë programor – Kanal 3 (RTM3) të shqiptohet masë - paralajmërim publik.

Rrjedhimisht nga sa më sipër, në bazë të nenit 18, paragrafi (1), nënparagrafi 20 dhe neni 23, paragrafi (1), nënparagrafi 1 nga LSHMAAV-së dhe në lidhje me nenin 14, dhe nenin 29, paragrafi (2) të LM-së, Udhëzimin për përmbushjen e detyrimeve për impresium dhe informacionit në dispozicion të përdoruesve, pika 7 dhe 14 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrjen e masës, Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer administrative nr.ark.10-2610/1 të datës 29.06.2026 dhe Konkluzionin nr.ark.02-2771/5 datë 16.07.2026, për konstatim të mos respektimit të nenit 14 nga LM, përcaktuar në pikën 1. të këtij Aktvendimi, Këshilli i Agjencisë gjatë seancës së 26-të të mbajtur më 16.07.2026, miratoi Aktvendim ku publikisht paralajmëron NPR RADIOTELEVIZIONI I MAQEDONISË Shkup – Televizioni i Maqedonisë – Shërbimi i tretë programor – Kanal 3 (RTM3), dhe urdhëron që në afat prej 20 (njëzet) ditësh nga dita e pranimi të Aktvendimit të harmonizojë punën e saj me dispozitat e LM-së. Pas skadimit të afatit të përcaktuar në pikën 2 të këtij Aktvendimi, Agjencia do të kryejë mbikëqyrje kontrolli, me qëllim të përcaktimit nëse subjekti i mbikëqyrjes, i cekur në pikën 1të këtij Aktvendimi, ka vepruar sipas Aktvendimit.

Në pajtim me nenin 24 të LShMAAV-së, ky Aktvendim është përfundimtar dhe kundër këtij aktvendimi transmetuesi ka të drejtë të ngrejë padi për iniciimin e kontestit administrativ pranë gjykatës kompetente. Padi për iniciimin e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimi të aktvendimit.

Bazuar nga sa më sipër, u miratua aktvendim si në dispozitiv.

#### **Shtojcë (1):**

1) Raport me shkrim për mbikëqyrje të kryer administrative, nr.ark.10-2610/1 datë 29.06.2026.

**Agjencia e Shërbimeve Mediatike  
Audio dhe Audiovizuele  
Kryetari i Këshillit,  
mr. Sasho Stefanovski d.v.**

**Këshillë juridike:** Kundër këtij aktvendimi transmetuesi ka të drejtë të ngrejë padi për iniciimin e kontestit administrativ pranë gjykatës kompetente. Padia për iniciimin e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimi të aktvendimit.

Përktheu: Antoneta Shabani .